




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

nga diskutimi i përgjithshëm publik me qytetarë, mbajtur më 23.12.2024, i cili filloi në orën 10:00.

Në diskutim morën pjesë qytetarët: Sejdi Ahmeti, Violeta Hasani, Shqipe Shkodra, Jeton Berisha, Blert Morina, Elirjeta Beka, Afrim Reçica, Orhan Avdiu, Shaqir Kqiku, Nexhmedin Bekteshi, Agim Miftari, Argjent Nela, Agim Maliqi, Enis Maliqi, Sami Bllaca, Dren Shahini, Jahë Balaj, Zymer Shala, Agron Kurti, Gani Dobratiqi, Ragip Lutolli, Dorina Luka-Davies, Donika Ahmetaj, Yll Rexhëbeqaj, Jetmir Gjemajlaj, Muharrem Hondozi, Fadil Hondozi, Rifat Gashi, Xhafer Tahiri, Samir Haliti.

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama - kryetar, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha - drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi - drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Donika Çetta - drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Adelina Sahiti - drejtore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, Gëzim Kastrati - drejtor i Drejtorisë së Transformimit, Bujar Gashi - drejtor i QKMF-së në Prishtinë.

Diskutimin me qytetarë e kryesoi **Osman Bllaca**.

Osman Bllaca: - fillimisht tha se, ne i kemi marr dy kërkesa nga qytetarët, Burim Gashi nga lagjja “Ulpiana”, i cili kërkon një informatë rreth procedurave për ndërrimin e kulmeve për banesat e vjetra dhe ato që janë të mbuluara me material të azbestit, si dhe pyetja tjetër e cila ka ardhur nga qytetari Petrit Haskaj, i cili kërkon nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, se çka po ndodh me kioskat dhe shitësit ambulantë në shesh.

Para se të fillohet me diskutimet e qytetarëve, **Përparim Rama** – kryetar, i njoftoi të pranishmit për punën e ekzekutivit të komunës gjatë këtij viti, i cili tha se jemi duke bërë një numër të madh të punimeve në të gjitha pjesët e kryeqytetit, në aspektin e infrastrukturës, rrugëve, kanalizimeve, në aspektin e edukimit, ndërtimin e shkollave, në aspektin e mjekësisë, si dhe në fusha të tjera. Kemi plane të projekteve strategjike të cilat i kemi planifikuar tash e dy vite dhe

tash vetëm jemi duke filluar, si p.sh., platforma e cila ndërlidh Pallatin me “Arbërinë”. Po ashtu e kemi planifikuar edhe sheshin “Xhorxh Bush”. Kemi krijuar drejtorinë e re, atë për Siguri dhe Emergjencë, ku kemi takime të rregullta me qytetarë ku edhe i diskutojmë së bashku dhe kemi ngrit sigurinë në nivel shumë më të mirë në kryeqytet. Kemi rritur numrin e hapësirave sportive dhe hapësirave rekreative, kemi përmirësuar gjendjen me grumbullimin e mbeturinave, si dhe shumë punë tjera që ndërlidhen me mirëqenien e qytetarëve.

Osman Bllaca: - hapi debatin për diskutim

Jahë Balaj, qytetar:- në cilësinë e kryetarit të këshillit lokal në lagjen “Lakrishte” tha se kam bërë mëse katër shkresa dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje e që kërkesa ka qenë për t’u siguruar një zyrë e këshillit lokal. Ne nuk kemi se ku të takohemi, zakonisht takohemi nëpër lokale të lagjes, pra në këtë kërkesë nuk kam marrë përgjigje. Po ashtu edhe kërkesa për gjendjen e “Platos”, ku deri më tani nuk është marrë asnjë hap për zgjidhjen e atyre problemeve që ka kjo hapësirë. Gjithashtu kemi edhe një problem me “Termokosin” rreth ndryshimit të faturave për pagesë e që në fakt i ka revoltuar në masë qytetarët.

Ragip Lutolli, qytetar:- në cilësinë e kryetarit të këshillit lokal në “Arbëria 2”, lagja “Përroi i njelmët”. Një kërkesë e kam drejtuar që ka të bëjë me rrugën e Mitrovicës që hyn në Prishtinë, rrugë e cila po bllokohet çdoherë dhe për me u lirua komunikacioni kam propozuar një rrugë, është hapsirë që është e lirë dhe nuk ka nevojë për kompensim me një gjatësi prej 1200 metra, dhe ndërtimi i kësaj rruge do të ndikonte në masë në lirin e komunikacionit.

Blert Morina, drejtor ekzekutiv në organizatën “Cel Kosova”:- tha se, për me qenë sa më konkret unë i kam tri çështje që kanë filluar para pesë viteve. “Dropping center” është bllokuar plotësisht për shkak se nuk janë lidh radiatorët të cilët ekzistojnë. Po ashtu si është e mundur që mos të kthehen përgjigjet nga drejtorja e Drejtorisë së Pronës, si dhe për një informacion jo të drejtë që po jepet nga kryetari, duke tentuar që ta bartin përgjegjësinë te organizatat për stehimore.

Dren Shahini, qytetar, banor i lagjes “Mati”, fillimisht ngriti disa shetësime si për atë në trafikun urban ku ceku se në linjen 3 të autobusit për shkak të hapësirës së qarkullimit të ajrit në autobus ka alivanosje të udhëtarëve. Po ashtu Prishtina kurr nuk ka qenë në shumë lagje më e papastër nga mbeturitat të cilat nuk po mblidhen. Në këtë lagje janë të bllokuara edhe pusetat e kanalizimit atmosferik, sepse një reshje më e vogël atje po përmythen bodrumet edhe po shkaktohen dëme të pariparueshme. Disa pritore të autobusëve janë në një gjendje jo të mirë, pasi që aty nuk kanë ulëse. Është më se shqetësuese se në Prishtinë nuk ka objekt që ka qenë në fazën e ndalimit të përkohshëm ose afatgjatë që s’kanë filluar punimet në qeverisjen e juaj dhe po i përfundoni dhe nuk di se si i bëni pranimet teknike të objekteve kur e dimë se për ndërtimin e tyre nuk janë përfill fare kriteret e

ndërtimit, etj. Si qytetar e shfrytëzoj rastin që drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, publikisht këtu me ia kërku dorëheqjen.

Sami Bllaca, qytetar nga lagjja “Mati 1”: - kërkoj nga kryetari të di arsyen, pse koficienti i ndërtimit në lagjen tonë, konkretisht te rruga “Sokol Sopi” është 1.2 dhe unë mendoj se për të gjithë banorët koeficienti duhet me qenë i njëjtë e jo me ndryshime.

Violeta Hasani, qytetare nga zona “Qendër”: - tha se kam një kërkesë nga Shoqata e bizneseve të vogla, lidhur me vendosjen e kioskave, ku derisa po iu jepet mundësia të gjitha kioskave me punuar, ndërsa këto po e shohin veten si të anashkaluar dhe unë besoj që kryetari do ta bëjë një zgjidhje, sepse janë në pyetje mbi 40 familje. Unë si një qytetare e japi një kontribut të jashtëzakonshëm prej vitit 2014, në bazë vullnetare për banorët e zonës “Qendër” që kemi realizuar projekte, e kemi bërë shumë të mirë këtë zonë dhe jam munduar të bëjë një komunikim të mirëfilltë me qytetarët.

Dorina Lluka Davies, përfaqësuese e organizatës “Vaimsiei”: - tha se ne si një organizatë që jemi punojmë me të rinj, me adoleshentë, kështu që duke e marrë parasysh numrin e madh të krimeve afër shkollave, shëndetin mendor të adoleshentëve, mungesën e aktiviteteve, numrin e madh të adoleshentëve që përdorin substanca narkotike e shumë çështje tjera, kërkojmë që të gjendet një hapësirë publike, ku aty të jetë një qendër rinore satellite ku do të trajtoheshin të gjithë ata të rinj, ata adoleshentë në një edukim të mirëfilltë.

Isa Rexha, qytetar: - në cilësinë e kryetarit të këshillit lokal Barilevë dhe Drenoc, kërkoj që në fshatin Barilevë të bëhet rregullimi i rrugëve në brendësi të fshatit. Po ashtu kërkoj që të bëhet edhe ndriçimi i këtyre rrugëve, si dhe të rregullohet rrejt i kanalizimit, kryesisht në lagjen “Verbovci”.

Shqipe Shkodra, qytetare afër rrugës “Rexhep Luci”:- e falënderoi kryetarin për realizimin e projekteve në këtë lagje, si dhe shumë projekte të tjera që janë filluar dhe pritet që ato të realizohen.

Jeton Berisha, qytetar nga lagjja “Kalabria”:- kërkoj nga kryetari që koeficienti i ndërtimit në këtë lagje të jetë 2.4, pra të jetë i njëjtë për të gjithë, pasi që koeficienti prej 1.5 është i papranueshëm.

Elirjeta Beka, përfaqësuese nga shoqata “Rrrjeti i grave të Kosovës”, i parashtrori këto kërkesa:

1. Shtimin e punëtorëve për punë sociale që kanë të bëjnë me dhunën në bazë gjinore, sipas protokollit për dhunë seksuale;
2. Shtimin e shtigjeve për biçikleta, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i tyre;
3. Mirëmbajtja e pllakave taktile për persona me aftësi të kufizuara për shkak që nuk janë të mirëmbajtura. Po ashtu edhe rritja e numrit të pllakave taktile që personat e verbër i përdorin. Komuna në bashkëpunim me policinë apo inspektoratin t’i largojnë veturat nga trotualet sepse kjo po ua pamundëson personave që përdorin karroca, si dhe prindërve me karroca me fëmijë që me i përdor trotualet kur kanë nevojë me i shfrytëzu.

4. Departamenti për financa të publikojë ankesin për buxhetim gjinor dhe një deklaratë gjinore.

Argjent Nela, qytetar afër rrugës "Fehmi Agani":- tha se, "Prishtina Parking" këtë rrugë e ka shndërruar në komerciale dhe ne si banorë nuk kemi qasje në parking. Janë dy parkingje prapa te kafet e vogla po atje veç disa banorë e kanë atë lluks me i parku veturat e tyre, por ne nuk e kemi at të drejtë. Kërkoj që të drejtën e parkingut ta gëzojmë edhe ne si qytetar të asaj zone.

Shaqir Kqiku, banor nga lagjja "Kalabria":- e përgëzoi kryetarin e komunës për guximin e marrë për lirim të hapësirës afër shkollës në këtë lagje, në ç'rast është bërë një zgjidhje për një kalim të sigurt, sidomos kur dalin nxënësit prej shkollës.

Agim Maliqi, banor i lagjes "Mati 1":- tha se ka më se katër vjet që kemi bërë kërkesë që koeficienti i ndërtimit të jetë 2.4, pasi që koeficienti prej 1.5 nuk na bënë zgjidhje, kështu që jemi disa banorë që jemi të anashkaluar me këtë koeficient. Kërkojmë që kjo çështje të rregullohet.

Samir Haliti, banor i lagjes "Mati 1":- rruga "Muharrem Fejza" tha se, me votim unanim me pjesëmarrje të banorëve është zgjedh këshilli i lagjes prej 9 anëtarëve. Ky këshill do të ketë mandat të përkohshëm, me qëllim deri në mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta dhe kërkojmë nga Drejtoria e Administratës që ta njoh këtë këshill. Kërkoj të dijë se si është planifikuar vazhdimi i pjesës së dytë të rrugës "Muharrem Fejza", si dhe disa rrugë tjera së bashku për intervenim në nivelizim të kubëzave, mbyllje të gropave të ato rrugë që janë ende me zhavorr, pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike, vendosjen e shtyllave antiparking përgjatë rrugës "Muharrem Fejza". Në rrugën "Jakov Xoxa", po ashtu kërkojmë të vendosen pengesa në rrugë me ndal shpejtësinë e automjeteve dhe vendosjen e pikave grumbulluese shtesë për kontejnerë për amvisëri dhe për mbeturinat e vëllimshme.

Muharrem Hundozi, banor i lagjes "Kalabria": - tha se, nuk pajtohem me planin rregullativ që ka të bëjë me "Kolektorin", pasi që ky plan i atakon dy parcelat e mia dhe unë si pronar legjitim i këtyre paqrcelave dëmtohem shumë, kështu që kërkoj që kjo ankesë e tij të merret parasysh dhe të bëhet një zgjidhje për pronat e mia.

Rexhë Beqaj, punëtor në "Prishtina Parking", si dhe në cilësinë e sekretarit të sindikatës të "Prishtina Parking":- kërkoj nga kryetari që të bëhet ndryshimi i rregullores, e cila parasheh vendosjen e bllokadave të veturave të qytetarëve për me iu ndërpre lëvizja e lirë në rast se nuk është bërë parapagimi për parking. Lidhur me këtë shtoi se mund të kemi incidente, ndoshta mund të shkaktohen edhe me pasoja të padëshirueshme.

Zymer Shala, qytetar nga Barileva:- tha se nga drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave kam marrë informatë se në fshatin Barilevë janë kryer 36 projekte, por kjo informatë nuk qëndron, pasi që në realitet janë përfunduar 5-6 projekte. Në fshatin Barilevë shumë rrugë janë të parregulluara, mungon ndriçimi i tyre, mungon rrjeti i kanalizimit, po ashtu kolektori në lagjen "Emshir", është plotësisht i parregulluar. Kërkoj që sa më shpejt të bëhet kyçja e lagjes "Kurti" me rrugën kryesore. Po ashtu kërkoj të dijë se çka është duke ndodhur me punimet rreth kanalizimit atmosferik në lagjen "Verbovci".

Për kërkesat, pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga qytetarët gjatë këtij debati publik, përgjigje dhanë: Përparim Rama - kryetar, Krenar Xhaferi - drejtor, Osman Bllaca - përfaqësues i ekzekutivit dhe Bekim Brestovci - drejtor.

Debati përfundoi në orën 12:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i debatit
Osman Bllaca

Faqe5nga5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Diskutim i përgjithshëm publik
23 Dhjetor, 2024
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënskrimi/Signature
1	Lejdi Ahmeti		anëtar		Lejdi Ahmeti
2	Vedeta Hoxha				Vedeta Hoxha
3	Shqipe Dato				Shqipe Dato
4	YETON BEKISHI				Yeton Bekishi
5	Bert Hoxha	Monica			Bert Hoxha
6	Romenda Sylbo				Romenda Sylbo
7	Elvira Be	Beke			Elvira Beke
8	Alvin	Rejica			Alvin Rejica
9	Olga	Arbica			Olga Arbica
10	SHARIE	Kaika			SHARIE Kaika

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nëshkrimi/Signature
11	Lexhueshij	BEKTESHI			
12	Ngan Pajkari	Milica			
13	ARSEN	NEKA			
14	AGIM MATI	MALICAI			
15	ENIS MATI	MALICAI			
16	SAMI	BLACA			
17	DREN	SHALINI			
18	JANE	BALLA			
19	Ygjeer	Shala			
20	Isa	KEKELI			
21	Arnor	MURAT			
22	GRANI	DEBETI			
23	Paqir	ZUTOLLI			
24	BOGDA	LUNA-BALLA			
25	Merita	SHMETI			
26	Yll	REXHIBEGASI			
27	Jetmir	MEHMOJAJ			
28					

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nëshkrimi/Signature
-----	-----------	-----------------	---------------	--------	---------------------

29	Makarem	Honololu					
30	Falil	Hendoi					
31	Rifas	GAHST					
32	MARE	JAHIRI					
33	SAHIL	HALIT					
34							
35							
36							
37							
38							
39							
40							
41							
42							
43							
44							
45							
46							

P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!


 Honololu

 Rifas

 MARE

 SAHIL